

1 Gjenerale

Tipi:	Mbledhje e kryesisë së FAK				
Data:	15-05-2019	Ora:	18:00	Vendi:	FAK – Prishtinë
Procesverbali i përgaditur nga:	Ardall Celina				

2 Pjesëmarrësit

Emri dhe mbiemri	Email adresa	Funksioni
ARDALL CELINA	ardall.celina@gmail.com	Sekretar i përgjithshëm
ARTAN VENHARI	artan.venhari@gmail.com	Kryetar
AVNI KUÇI	avni.kuci@king-ks.com	Nënkryetar
EDUARD DACI	eduard.daci.95@gmail.com	Anëtar i bordit
FANOL SHALA	fanolshala21@gmail.com	Anëtar i bordit
NAIM UKAJ	naim.ukaj@hotmail.com	Anëtar i bordit
SHKUMBIN VULA	binvula@hotmail.com	Anëtar i bordit
BERAT BEJTULLAHU	bbejtullahu@hotmail.com	Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

3 Lista e pranuesëve të procesverbalit

Emri dhe mbiemri / Institucioni	Email adresa	Institucioni
Kryesisë së FAK	kryesia@aeronautika.org	FAK
* Të gjitha aeroklubeve anëtarë të FAK (* Lista e vendimeve të mara që janë pjesë e procesverbalit)	klubet@aeronautika.org	FAK

4 Agjenda

#	Titulli	Komente
1	Raporti financiar i tremujorit të parë TM1 2019	
2	Planifikimi i buxhetit dhe shpenzimeve për tremujorin e dytë TM2 2019	
3	Përcaktimi i datave të mundshme për organizim të kursit SIV	
4	Të tjera	

5 Diskutimet / Vendimet

#	Titulli	Komente
1	Raporti financiar i tremujorit të pare TM1 2019 1.1 Sekretari i FAK Ardall Celina, prezantoi raportin e shpenzimeve per TM1, si dhe dokumentet e përgaditura për raportim ndaj donatorit të vetëm të FAK, MKRS për TM1. 1.2 Shpenzimet e TM1 2019 të përgaditura për raportim në MKRS: 2830.00 - Anetaresia ne FAI 2019 500.00 - Auditimi financiar i Federates 2018 1274.00 - Rekuizita per organizim te garave - Ozone StarTent 1050.00 - Kuotizimi per garen e paragllajdzimit distance - SkyTribe XC 2019, Romaina 700.00 - Obligimet per shperblime sipas marrveshjes per kampionati kombetar 325.00 - Kuotizimi per meshkujt (13) - Gjiro Open Air 2019 225.00 - Kuotizimi per femrat (3) - Gjiro Open Air 2019 800.00 - Trajnimi i piloteve te rinje sipas memorandumit te bashkepunimit me KK Istog 693.84 - Punimi i Dekoratave 60 cope dhe Kutite e plishit 28 cope 190.00 - Rregjistrimi i garave kombetare ne FAI (3 gara) 400.00 - Trajnimi i piloteve femra (Pilotja: Shpresa Rrahmani) 107.00 – Ushqim dhe pije për paradën e ditës së pavarësisë 200.00 – Anetaresia e FAK ne KOK 2019 101.40 - Shpenzimet bankare - mirembajtja e llogarise dhe transferet 9396.24 EUR - TOTAL 1.3 Theks të veçantë në raport kishte urgjenca me të cilën është përballur bordi i FAK për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për TM1, ashtu që FAK të mos humb përkrahjen financiare nga MKRS për këtë periulle. Kjo për shkak të periudhës së vështirë të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në FAK dhe marrjen me vonesë të qasjes në llogarinë bakare të personave përgjegjës nga FAK. Megjithatë bordi arriti që gjatë periudhës së shkurtër të realizoj objektiva dhe buxhetin e paraparë nga MKRS për këtë periudhë kohore. 1.4 Pas kompletimit të plotë të raportit dhe të dokumenteve përcjellëse për këtë tremujor (TM1 2019), sekretari deklaroi se të njejtin raport do t'ia dërgoj të gjitha klubeve për informim, si dhe bashkë me raportin do të dërgoj edhe listën e transaksioneve bankare për këtë periudhë kohore.	

#	Titulli	Komente
	1.5 Gjithashtu u diskutua edhe diskrepanca në mes të gjendjes reale bankare të FAK dhe raportit të prezantuar gjatë pranimdorëzimit të detyrës nga presidenti paraprak në atë aktual. - Në këtë diskutim theks të veçantë kishte diskrepanca në në raportin financiar të 2017, më saktë në deklarimin e gjendjes fillestre të keshit në fillim të vitit 2017, në këtë deklaratë figuron gjendja e keshit në fillimvit të jetë negative, pra minus më shumë se 5000 EUR, ndërsa pas verifikimit të llogarisë bankare shihet se gjendja reale bankare në këtë periudhë është pozitiv, pra plus më shumë se 2000 EUR. - Nga bordi u konstatua se pikërisht ky gabim në raportin financiar të vitit 2017 ka bërë që në dokumentin e pranim-dorëzimit të detyrës, FAK të figuroj që ka obligim financiar ndaj huadhënësve, e që në realitet pas përmirësimit të këtij gabimi shihet qartë se FAK nuk ka asnjë obligim financiar të bartur ndaj ndonjë huadhënësi. - Bordi kërkoi nga sekretari të diskutoj edhe me kryetarin paraprak të FAK, Z. Gërguri, në mënyrë që të identifikoj mos ndoshta gjendja negative fillestare e keshit në fillim të vitit 2017, ka të bëjë me ndonjë huazim përmes parave në dorë nga bordi i atëhershëm i cili ka përfunduar mandatin në fund të vitit 2016. - Bordi konstatoi që nëse konfirmohet se FAK nuk ka obligim financiar të bartur në fillim të vitit 2017, i cili mund arsyetohet nga udhëheqësia e FAK deri në fund të vitit 2016, dhe të dokumentohet shpenzimi dhe arsyet se pse FAK ka hyrë në ndonjë huazim me para në dorë dhe nuk ka raportuar për këtë, atëhere konfirmohet se FAK nuk ka asnjë obligim të bartur në mandatin aktual.	
2	Planifikimi i buxhetit dhe shpenzimeve për tremujorin e dytë TM2 2019 2.1 Në mënyrë që të arrihen objektivat e planifikuara për TM2 dhe të planifikohet shpenzimi i mjeteve të ndara nga MKRS për këtë periudhë kohore, bordi aprovoi aktivitetet në vijim: - Dy garat ndërkombëtare në Rumani - Të sigurohet të garat e ligës ekipore të Kosovës të organizohen me kohë - Garat e kampionatit kombëtarë të paraparë me kalendarin e garave të përkrahen financiarisht - Blerja e pajisjeve për testim teknik të paragllajdëve - Inicimi i trajnimit për testim teknik të paragllajdëve - Organizimi i kursit të SIV për pilotët	

#	Titulli	Komente
3	Përcaktimi i datave të mundshme për organizim të kursit SIV 3.1 Bordi u dakordua organizimi i kursit të SIV të bëhet në dy grupe, ashtu që caktoi datat 21-23 Qershor dhe 28-30 Qershor si data të përshtatshme për organizim të SIV. 3.2 Bordi autorizoi fillimin e diskutimeve me instruktorin ndërkombëtar për SIV, Z. Mendo Veljanovski për të përcaktuar dhe konfirmuar datat e kursit.	
4	Të tjera 4.1 Bordi nxorri vendim që të përkrahë financiarisht organizimin e ligës ekipore të kosovës, ashtu që: - Gjyqtarët e garave të ligës ekipore të kosovës për vitin 2019 të sigurohen dhe të kompenzohen nga FAK. Çdo gjyqtarë që angazhohet në këto gara do të kompenzohet me 20 EUR nga FAK. - Klubet fituese të ligës ekipore të kosovës do të shpërblehen si në vijim: - o Diciplina precision: Vendi i parë: 400 EUR Vendi i dytë: 300 EUR Vendi i tretë: 200 EUR - o Diciplina distancë: Vendi i parë: 300 EUR Vendi i dytë: 200 EUR Vendi i tretë: 100 EUR 4.2 Bordi nxorri vendim që të përkrahë financiarisht organizimin e ligës ekipore të kosovës, ashtu që:	

6 Detyrat

6.1 **Kryetari:** Të kërkoj kthimin e laptopit nga kryetari paraprak i FAK.

6.2 **Sekretari:** Të inicioj diskutimin për organizim të kursit SIV.

6.3 **Sekretari:** Të diskutoj me ish kryetarin e FAK, Z. Gërguri për identifikimin e arsyeve të mundshme për shfaqjen e gabimit në raportin financiar 2017.

7 Të tjera

N/A